

# UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT **A1**

## PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2008

### I. UDHËZIME TË PËRGGJITHSHME

1. Për t'u regjistruar në provimet e Maturës Shtetërore 2008 duhet të plotësohet **Formulari A1** nga të gjithë nxënësit maturantë dhe ata nxënës që janë mbetës në vitet e mëparshme.
2. **Formularin A1** duhet ta plotësojnë edhe nxënësit që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2008 dhe që dëshirojnë të japin provimet e lëndëve me zgjedhje për të ndjekur studimet në shkollat e larta.
3. **Formulari A1** të plotësohet me shkronja të mëdha (kapitale).
4. **Formulari A1** në pikën 4 të plotësohet në bashkëpunim me mësuesin kujdestar.
5. **Formulari A1** në pikat 5 dhe 12 të plotësohet në bashkëpunim me **drejtorin e shkollës**.
6. **Formulari A1** do të konsiderohet i vlefshëm **VETËM** nëse ai është plotësuar në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme. Në rast të kundërt ai do të konsiderohet i pavlefshëm dhe ju, humbisni të drejtën e regjistrimit.
7. Pasi ta keni plotësuar **Formularin A1**, dorëzoheni atë pranë **Komisionit Shkollor të Maturës Shtetërore (KSHMSH)**, ku vazhdoni ose keni mbaruar shkollën.
8. Në rast se ka bërë gabim në plotësim, kandidati mund të bëjë koregjime, duke plotësuar dhe dorëzuar një tjetër Formular **A1**, brenda afatit të dorëzimit të tij (10 mars 2008). Pas këtij afati kandidati **NUK** ka të drejtë të bëjë ndryshime.
9. Plotësimi dhe dorëzimi i **Formularit A1**, fillon me datë **20 shkurt 2008** dhe përfundon me datë **10 mars 2008**.
10. **Formulari A1**, pas plotësimit të kontrollohet me kujdes për saktësinë dhe më pas të firmoset nga nxënësi, mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës. Çdo formular të vuloset me vulën e shkollës..
11. **Pas plotësimit të formularit A1 bëhet një fotokopje e tij ,e cila ruhet në shkollë.**

### II. UDHËZIME TË DETAJUARA PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1

Në hapësirat e lëna bosh tek Formulari **A1**, plotësoni:

1. Shkruani emrin e rrethit ku ndodhet shkolla pranë së cilës ju do të jepni provimin;
2. Shkruani emrin e qytetit ose fshatit, në të cilin ndodhet shkolla juaj;
3. Shkruani emrin e shkollës ku ju po studjoni ose ku ju keni kryer studimet;
4. Të plotësohet në bashkëpunim me mësuesin kujdestar;

Bazuar në tabelën Nr.1 (Indekset e profileve/degëve), gjeni indeksin e degës dhe shënoni numrin që përfaqëson dega që ju po ndiqni ose keni ndjekur, p.sh. SHMP Drejtimi Shoqëror, në tabelë ka indeksin 02, në formular ju do shënoni numrin **02**.

5. Shënoni ID që keni patur në Maturën Shtetërore 2007. Plotësohet në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, **VETËM** për ata nxënës që kanë dhënë provimet e detyruara ose me zgjedhje, si dhe për ata nxënës që kanë mbetur në një ose në të dy provimet e detyruara, në Maturën Shtetërore 2007 (vitin e kaluar).

Nxënësit e që mbarojnë shkollën këtë vit (2008), do të pajisen me **numër regjistrimi (ID)** nga **AVA** pas përfundimit të procesit të mbledhjes së të dhënave (neni 34 i rregullores së Maturës Shtetërore 2008).

6. Shënoni emrin tuaj                      Shënoni emrin e babait                      Shënoni mbiemrin tuaj

**Kujdes!** të shënohen me shkronja kapitale dhe në përputhje me çertifikatën personale.

7. Shënoni datëlindjen tuaj, duke plotësuar me dy shifra ditën dhe muajin, (p.sh. 05/12/1989).

8. Vendosni një shenjë në formë kryqi në kutinë që i përket gjinisë suaj. P.sh. nëse i përkisni gjinisë femërore shënoni një kryq [X] në kutinë përbri fjalës “Femër”;

9. Shënoni vitin kur keni përfunduar studimet në shkollën e mesme, për nxënësit që kanë mbaruar shkollën para vitit 2008, (p.sh. 2005 ose 2006 ose 2007). Maturantët e këtij viti(2008) shënojnë “KËTË VIT”.

10. Nxënësit që duan të vazhdojnë studimet jashtë shtetit shënojnë një kryq [X] në kutinë përbri PO.

11. Qarkoni IV ose V dhe shkronjat përkatëse A, B, C, D, E, F, G, H, I, K, L, M, N, O, P, Q, R, S, U, . (P.sh. nëse jeni në klasën IV B, qarkohet IV dhe shkronja B dhe nëse jeni në klasën V D, qarkohet V dhe shkronja D). Kur nxënësi ka mbaruar studimet para vitit 2008, qarkohet shkronja U.

Në rastin kur shkolla ka përdorur numra për emërtimin e klasave, mësuesi kujdestar të konvertojë, numrin në shkronjë, sipas radhës së përcaktuar më sipër.

12. Plotësohet në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, vetëm për nxënësit që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2008.

Shënoni me përgjegjësi lëndët dhe notat e shkallëzuara D1 dhe D2, për nxënësit që kanë dhënë provimet me detyrim në Maturën Shtetërore 2006, 2007. Për nxënësit që kanë mbaruar maturën para vitit 2006, do të vendosen notat ekuivalente me provimet e detyruara. Në këtë rast ekuivalentimi bëhet në përputhje me **Dëftesën e Pjekurisë origjinale**.

13. Bazuar në listën e lëndëve me zgjedhje të poshtëshënuar qarkoni 2 lëndët me zgjedhje që do të jepni provim dhe numrat që u korrespondojnë atyre.

P.sh. **4 HISTORI** dhe **6 NJOHURI PËR SHOQËRINË**.

**Shënim:**

- Nxënësi, firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Mësuesi, shkruan emrin dhe mbiemrin (me shkronja kapitale) dhe firmos në hapësirën e përcaktuar për të.
- Drejtori, shkruan emrin dhe mbiemrin (me shkronja kapitale) firmos dhe vulos me vulën e shkollës, në hapësirën e përcaktuar për të.

## INDEKSET E PROFILEVE / DEGËVE

INDEKSET	DEGËT
01	SH. M. P. DREJTIMI NATYROR
02	SH. M. P. DREJTIMI SHOQËROR
03	SH. M. P. DREJTIMI I PËRGJITHSHËM
04	SH. M. P. E PAPROFILIZUAR (PARA 2007)
05	SH. M. P. E PËRGJITHSHME ME KOHË TË SHKURTUAR
06	NATYROR 2 GJUHËSH FRANCEZE
07	SHOQËROR 2 GJUHËSH FRANCEZE
08	SHOQËROR 2 GJUHËSH ITALIANE
09	GJUHË E HUAJ ANGLISHT
10	GJUHË E HUAJ FRËNGJISHT
11	GJUHË E HUAJ GJERMANISHT
12	GJUHË E HUAJ SPANJISHT-RUSISHT
13	GJUHË E HUAJ ITALISHT
14	ARTISTIKE KOREOGRAFI
15	ARTISTIKE ARTE FIGURATIVE
16	ARTISTIKE MUZIKË
17	SPORTIVE FUTBOLL
18	SPORTIVE ATLETIKË
19	SPORTIVE VOLEJBOLL
20	SPORTIVE BASKETBOLL
21	PEDAGOGJIKE 4 VJEÇARE
22	PEDAGOGJIKE GREQISHT GJIROKASTËR
23	TEKNIKE 5 VJEÇARE( BANKA/TATIME/SIGURIME)
24	TEKNIKE EKONOMIKE 5 VJEÇARE TURIZËM
25	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 FERMER
26	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 HOTELERI TURIZËM
27	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 MAKINERI BUJQËSORE
28	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 TEKNOLOGJI USHQIMORE BYLMET MISH
29	TEKNIKE PROFESIONALE 3+2 TEKNOLOGJI USHQIMORE PIJE KONSERVA
30	TEKNIKE 5 VJEÇARE VETERINARI
31	TEKNIKE 5 VJEÇARE AGRO BIZNES
32	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTRIK I PËRGJITHSHËM
33	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTRONIKË
34	TEKNIKE 5 VJEÇARE ELEKTROTEKNIKË
35	TEKNIKE 5 VJEÇARE MEKANIK I PËRGJITHSHËM
36	TEKNIKE 5 VJEÇARE POLIGRAFIK
37	TEKNIKE 5 VJEÇARE PYJE
38	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNIK GJEODET
39	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNIK NDËRTIMI
40	TEKNIKE 5 VJEÇARE TEKNOLOGJI USHQIMORE
41	TEKNIKE 5 VJEÇARE TELEKOM
42	HARRY FULTZ MENAXHER AUTOMOBILASH
43	HARRY FULTZ BIZNES
44	HARRY FULTZ ELEKTRIKE
45	HARRY FULTZ ELEKTRONIKË
46	TEKNIKE 4 VJEÇARE (PARA 2007)
47	TEKNIKE PROFESIONALE ME KOHË TË SHKURTUAR
48	PROFILI IM S'ËSHTË NË LISTË